



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 7751 prot.

Roskovec, më 30.08.2022

VENDIM

Nr. 59, datë 29.08.2022

PËR

**CAKTIMIN E PËRFAQËSUESIT LIGJOR PËR PËRFAQËSIMIN E KËSHILLIT
BASHKIAK ROSKOVEC NË ÇËSHTJEN GJYQËSORE PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetqeverisjen vendore”, të ndryshuar; të nenit 72 të Ligjit Nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 14 të Ligjit Nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar; të nenit 92 dhe nenit 96 të Ligjit Nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; Rregullores për funksionimin e Këshillit Bashkiak Roskovec; Rregullores së Brendshme të Bashkisë Roskovec dhe Fletëthirrjes Nr. 130 Akti, datë 18.07.2022, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Caktimin e përfaqësuesit ligjor për mbrojtjen dhe përfaqësimin e Këshillit Bashkiak Roskovec në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, në çështjen me palë dhe objekt padie si më poshtë:

Paditës	Prefekti i Qarkut Fier,
Të paditur:	Këshilli i Bashkisë Roskovec Bashkia Roskovec
Palë e tretë:	Avokatura e Shtetit
Objekti i padisë:	Deklarimin e pavlefshmërisë së aktit nënligjor normativ të Këshillit të Bashkisë Roskovec, Vendimit nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 93, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”.

Shfuqizimin tërësisht të Vendimit nr. 21, datë 29.03.2022 “Për një shtesë në Vendimin nr. 93, datë 25.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”.

2. Këshilli i Bashkisë do të përfaqësohet në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë nga Bashkia Roskovec, sipas autorizimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec për një nëpunës të caktuar të kësaj Bashkie.
3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike me zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARI

Kadri Hyska

